



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 451/prot.

Tiranë, më 17.03.2026

VENDIM

Nr. 21, datë 17.03.2026

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 11, DATË 10.4.2025**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 11, datë 10.4.2025, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Berat dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës",

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 125, datë 20.12.2024 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Berat", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 11, datë 10.4.2025, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Berat dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës", ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me shkresën nr. 799 prot., datë 9.9.2025, Komisioneri ka kërkuar informacion mbi zbatimin e vendimit nr. 11/2025. Në përgjigje të kësaj shkrese, institucioni Bashkia Berat ka njoftuar Komisionerin mbi masat dhe veprimet administrative të ndërmarra për zbatimin e vendimit paralajmërues, me shkresat nr. 5148/1 prot., datë 22.7.2025, "*Dërgim informacioni*", dhe nr. 1266 prot., datë 24.2.2026, "*Mbi ecurinë e zbatimit të detyrave të lëna*".

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.11, datë 10.4.2025, si dhe referuar informacionit të dërguar nga subjekti, konstatoj se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

1. Lidhur me zbatimin e pikës 2 të Vendimit

Në pikën 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra në administrimin e shërbimit civil, konkretisht komiteti i vlerësimit, analisti i punës dhe eprorët direkt, përfundimin e procesit të klasifikimit racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën përkatëse, në përputhje me përcaktimet e nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe me pikën 5 të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, duke ndjekur procedurën dhe orientimet e përcaktuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara konstatoj se, me shkresën nr. 5935/1 prot., datë 5.11.2024, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Bashkisë Berat ka përcaktuar grupin e punës përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi pozicionet e punës në strukturën aktuale të shërbimit civil. Në përfundim të këtij procesi, grupi i punës ka përgatitur një raport përmbledhës, në të cilin janë pasqyruar rezultatet e analizës së pozicioneve të punës, duke përfshirë përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi, nivelin e arsimit, fushën e studimeve dhe përvojën e kërkuar në punë për secilin pozicion.

2. Lidhur me zbatimin e pikës 3 të Vendimit

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Bashkia Berat që procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë (relacion apo memo) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar vërej se Bashkia Berat ka përmbushur këtë detyrim, duke e dokumentuar procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në aktin shoqërues të strukturës, konkretisht aktin nr. 1, datë 27.10.2025, "*Për miratimin e listës së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, si pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Berat*".

Në vijim të këtij procesi, dhe në përputhje me kërkesën për formalizimin e strukturës organizative, është miratuar vendimi nr. 832, datë 5.12.2025, *“Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2026”*, akt i cili përfshin pozicionet e klasifikuara si pjesë e shërbimit civil.

3. Lidhur me zbatimin e pikës 4 të Vendimit

Në pikën 4 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit.

Gjithashtu është kërkuar që në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuar në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.

Nga dokumentacioni i administruar konstatoj se Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat ka informuar Komisionerin se, me vendimin nr. 33, datë 15.1.2026, *“Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2026”*, është miratuar plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil për vitin 2026. Nga përmbajtja e këtij akti rezulton se plani i rekrutimit është hartuar në përputhje me strukturën e miratuar të institucionit dhe përfshin pozicionet vakante, duke reflektuar nevojat reale për plotësimin e tyre nëpërmjet procedurave konkurruese.

4. Lidhur me zbatimin e pikës 5 të Vendimit

Në pikën 5 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë që, në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil dhe parimet e ligjshmërisë administrative, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për tre punonjës, si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative për shpalljen e pozicioneve përkatëse si vende të lira, me qëllim plotësimin e tyre nëpërmjet procedurave të konkurrimit, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar vërej se Bashkia Berat, përmes shkresës nr. 1266 prot., datë 24.2.2026, ka informuar Komisionerin se, në zbatim të detyrimit të përcaktuar në vendimin paralajmërues, janë ndërmarrë veprimet përkatëse administrative për lirimin nga detyra të punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin dhe për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve përkatëse në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Në përfundim të këtyre procedurave konkurruese janë emëruar si nëpunës civilë në periudhë prove:

- :: Kristen Gjika, me aktin nr. 276, datë 7.4.2025, të titullarit, në pozicionin “Specialist për kontrollin tatimor në terren”;
- :: Xhezmi Delilaj, me urdhrin nr. 275, datë 7.4.2025, të titullarit, në pozicionin “Specialist për taksat dhe tarifatat në Njësinë Administrative Sinjë”;
- :: Klida Çifliku, me urdhrin nr. 821, datë 21.11.2025, në pozicionin “Specialist i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve”.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar dhe sa u parashtrua më sipër, çmoj se Bashkia Berat ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmërues nr. 11, datë 10.4.2025, të Komisionerit, duke ndërmarrë veprimet administrative të nevojshme për rregullimin e situatës së konstatuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 11, datë 10.4.2025, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Berat dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Berat duke zbatuar detyrat e lëna të dispozitivit të Vendimit nr.11, datë 10.4.2025.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Berat.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefte (L. LUZI)

